



## **TAKIMI I MJEKËSISË NË DIASPORË**

Më 20 shkurt në Tiranë u zhvillua Takimi i Mjekësisë në Diasporë. Një takim i veçantë dedikuar profesionistëve në fushën e mjekësisë, përfshirë mjekë shqiptarë me veprimtari profesionale në Gjermani, Itali, Greqi, Rumani, Portugali, Zvicër, Mali i Zi e vende të tjera si dhe mjekë nga Diaspora që janë rikthyer në vendin e origjinës.

Ky takim u zhvillua në dy panele: "Politikat dhe programet e punësimit në sektorin e shëndetësisë" dhe "Inovacionet në shëndetësinë shqiptare dhe raste suksesi", të cilat kishin si qëllim diskutimin mbi politikat shëndetësore, programet e punësimit, zhvillimet e fundit në sektorin e shëndetësisë shqiptare si dhe nxitjen e bashkëpunimit mes profesionistëve shqiptarë në fushën e mjekësisë.



### **Më poshtë disa nga përshtypjet e mjekëve pjesëmarrës:**

*Ky paneli i parë mu duk si një nismë shumë e mirë. Flas për veten time, është kontakti i parë në rrugë më zyrtare me vendin tim pas ikjes time jashtë. Në lidhje me aktivitetin, mendoj nga ana ime, pozitive, pavarësisht nga disa probleme që u konstatuan. Po është normale se është aktiviteti i parë dhe gjithmonë sugjerimet dhe kritikët shërbejnë për përmirësim në të ardhmen në aktivitetet e ardhshme.*

**Dr. Altin Ndrio – Ambasador i Kombit, Mjek në Portugali**

*"Rëndësia më e madhe e konferencës ishte fakti që ne, si mjekë të diasporës, u prezantuam, sepse edhe ne jemi pjesë të këtij realiteti dhe fakti që ne jemi larguar, nuk do të thotë që ne nuk ekzistojmë. Ky ballafaqim edhe me institucionet shqiptare ishte një vlerë e madhe për mua. Duke qenë se ishte takimi i parë dhe ishte më me rëndësi që ne të njiheshim dhe të prezantoheshim me njëri-tjetrin".*

**Dr. Marsela Ceno - Mjeko kirurge në Gjermani**



*"Ishte goxha e mirë-organizuar, më pëlqeu ideja e organizatave të mjekëve që janë të organizuar në shtete të ndryshme dhe krijojnë lidhje me njëri-tjetrin....mund ta bëjmë edhe ne këtë gjë në Rumani. Kjo sepse është e vështirë për student të farmacisë dhe të mjekësisë që të aplikojnë për specializimin, pasi nuk kanë të drejtë të organizohen me urdhrin e mjekut apo të farmacistit. Do ishte diçka e mirë që një studenti t'i thuhet më përpara se ku po hyn që ta dijë se ku po shkon...edhe këtë gjë mund ta organizojmë edhe ne. Në të ardhmen, do dëshiroja të kishte përfaqësim nga të gjitha specializimet m fushës së shëndetësisë: mjekësi, farmaci, stomatologji".*

**Dr. Erand Mati – Farmacist në Rumani**

*"Kjo është gjëja më e mirë që mund të japi diaspora sepse jep eksperiencën që ka ajo diasporë kudo që është dhe ja jep të gatshme mjekësisë shqiptare. E rëndësishme është që mjekët shqiptarë dhe institucionet mjekësore në Shqipëri të dinë të afrojnë dhe të jenë të hapur për bashkëpunim sepse kështu mund të ecim të dy, edhe ne edhe juve".*

**Dr. Edvin Vaso - Shef i Klinikës së Gjinekologjisë në Spitalin e Mediaş-it në Rumani**

